

KONTRATË SHITJEJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë **07.07.2020**, palët:

Z. Jonaid Myzyri, me datëlindje 27.06.1990, lindur dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr.Personal **J006270770**, që më poshtë do të quhet **Shitësi**;

DHE

Znj.Valbona Ndrepepaj, me datëlindje 12.11.1989, lindur në Bajram Curri dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal **I96112038Q**, që më poshtë do të quhet **Blerësi**;

Bazuar në nenin 73/1/b, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëirtë Tregëtare”, i ndryshuar, si edhe në nenet 705 e vijues të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bien dakord si më poshtë:

PARASHTRIMET:

- a. Shoqëria “Agro Polis” Shpk është regjistruar në regjistrin tregëtar Shqiptar më datë 09.01.2020, identifikuar me numër NUIS **M01309008R**, me adresë në qytetin e Tiranës, - Rruga “Sami Frasheri”, Pallati Titan Construction, Kati 4, Ap.7”, me objekt aktiviteti sipas statutit të shoqërisë, si edhe përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor Znj.Valbona Ndrepepaj, me datëlindje 12.11.1989 lindur në Bajram Curri dhe banues në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë j për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal **I96112038Q**;
- b. Referuar ekstraktit të regjistrit tregëtar, aksionerët e shoqërisë janë:
 - **Jonaid Myzyri** aksioner me **51,00 %** të aksioneve të shoqërisë
 - **Gëzim Fezulli** aksioner me **49,00 %** të aksioneve të shoqërisë
- c. Referuar ekstraktit të regjistrit tregëtar Shitësi **Jonaid Myzyri**, shfaqet në cilësinë e ortakut të shoqërisë “Agro Polis” Shpk, regjistruar në Regjistrin Tregëtar Shqipëtar më



datë 09.01.2020, me me Nr. NUIS M01309008R zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 51.000 lekë e cila është 51% e kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 1 OBJEKTI

1. Objekt i kësaj kontrate është shitja nga aksioneri Z.Jonaid Myzyri i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 51.000 lekë e cila është 51 % e kapitalit të shoqërisë “Agro Polis” Shpk, Znj. Valbona Ndrepepaj, me datëlindje 12.11.1989 lindur në Bajram Curri dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal **I96112038Q**.

NENI 2 QËLLIMI

1. Qëllimi është transferimi i pronësisë së kuotës së mësipërme, objekt i kësaj kontrate, nga shitësi tek blerësi kundrejt çmimit të parashikuar në këtë kontratë.
2. Kalimi i pronësisë nga shitësi tek blerësi do të bëhet në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët.

NENI 3

ÇMIMI I SHITJES

1. Cmimi i shitjes është 51.000 ALL.
2. Pagimi i shërbimit të kryer do të bëhet CASH dhe në ditën e nënshkrimit të Kontratës

NENI 4

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

1. Shitësi ka të drejtë të kërkojë pagimin e çmimit nga blerësi në mënyrën dhe afatin e caktuar në këtë kontratë.
2. Shitësi garanton blerësin për gëzimin e qetë të kuotave nga çdo e drejtë apo pretendim i të tretëve.
3. Shitësi garanton blerësin se kuotat nuk janë vendosur në barrë siguroese si edhe ndaj tyre nuk ka asnjë urdhër për sekuestro të cdo lloj forme.
4. Kuotat si pjesë e investimit të kapitalit fillestar në shoqëri janë investuar si burim i ligjshëm i të ardhurave të shitësit

5. Shitësi është i detyruar të marrë pjesë në gjykim në mbështetje të blerësit nëse ai thirret prej tij për të garantuar ndaj pretendimeve të personave të tretë, mbi kuotat.
6. Blerësi duhet të paguajë çmimin e përcaktuar në këtë kontratë.
7. Blerësi ushtron të gjithë të drejtat, detyrimet dhe përfitimet që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë.

NENI 5

DISPOZITA TË TJERA

1. Kjo kontratë u hartua në 2 kopje me fuqi të barabarta secila në gjuhën shqipe
2. Për çdo problem palët duhet të komunikojnë me njëra-tjetrën dhe të mundohen t'i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet e tyre dhe vetëm në pamundësi t'i drejtohen Gjykatës kompetente sipas ligjit në fuqi.
3. Palët duhet të respektojnë detyrimet që rrjedhin për ta nga kjo kontratë deri në përfundim të kësaj kontrate, në të kundërt do të lindin pasojat që parashikohen në këtë kontratë si dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.
4. Kjo kontratë hyn në fuqi menjherë me nënshkrimin e saj nga palët

PALËT

Shitësi

Z.Jonaid MYZYRI

Blerësi

Znj. Valbona NDREPEPAJ

